



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHQETRORE PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE			
DRZAVNA AGENCIJA ZA ZASTITU LICNIH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRTRE ARSHIVY KANCELARSHA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE			
Nr. Org.	01	Nr. Prot.	126
Org. Idrin		Isz. Prot.	
Org. Unit		Prot. No.	
Nr. ifaqeve	02	Data	23.07.2013
Prot. No.		Isz. Data	
		Date	

Republika e Kosovës 02
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 26 /13
Datë: 23.07.2013

Në mbështetje të nenit 49 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 70/2010) Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, merr këtë:

V E N D I M

1. **Urdhërohet**, Kolegji UNIVERSUM që të ndalojë përpunimin e karakteristikave biometrike (gjurmët e gishtërinjve) për punonjësit e administratës dhe stafit të përhershëm në Kolegj.
2. Në afat prej 15 ditëve të njoftohet Agjencia për zbatimin e vendimit.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimi të vendimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 46 paragrafi 1 dhe nenit 47 paragrafi 1 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejshëm LMDHP), Agjencia ka realizuar inspektim në Kolegjin Universum, më datën 22.07.2013.

Inspektimi në Kolegjin Universum është realizuar me qëllim të njohjes së procedurave të përpunimit të dhënave biometrike (gjurmët e gishtërinjve) a realizohet për punonjësit e administratës dhe stafit të përhershëm që punojnë në Kolegj me qëllim të hyrje - daljes nga puna.

Pas kryerjes së inspektimit është përpiluar procesverbali me nr.21/2013, ku një kopje e procesverbalit i është dorëzuar zyrtarit të pranishëm në inspektim përkatësisht Drejtorit të Administratës.

Gjatë inspektimit në Kolegjin Universum, është konstatuar se bëhet përpunimi i të dhënave biometrike (gjurmët e gishtërinjve) për punonjësit e administratës dhe stafit të përhershëm që punojnë në Kolegjin Universum, me qëllim të kontrollit të hyrje - daljes nga puna, kjo bëhet në kundërshtim me nenin 68 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, në të cilin thuhet qartë se në sektorin privat mund të përdoren karakteristika biometrike vetëm nëse kjo është e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve për sigurinë e njerëzve për sigurinë e pronës ose për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale ose sekreteve të biznesit.

Në këtë rast përdorimin i karakteristikave biometrike për regjistrim të hyrje daljeve, nuk është në harmoni me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe konsiderojmë se masa e mbikëqyrjes së hyrje daljeve mund të arrihet me mjete më të lehta.

Siç është përkthyer në arsyetimin e lartë cekur dhe bazuar në nenin 49, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror

Ruzhdi Jashari



Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit Universum
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë